

Butrint Shabani
HISTORIKU I PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI,
ASPEKTE KRAHASIMORE

Abstrakti

Partitë politike përbëjnë një nga faktorët dhe mënyrat e përfaqësimit të sovranitetit popullor nëpërmjet shtetit, veprimtaria dhe qëndrimet e të cilit përcaktohen nga vullneti i subjekteve politike që marrin besimin e qytetarëve për të qeverisur. Në parim çdo parti krijohet për të marrë pushtetin, dhe përmes tij zbatuar plan programin dhe vizionin politik të saj, por edhe për të menaxhuar dhe vendosur lidhur me çështjet shtetërore, politike, ekonomike, sociale, shëndetësore, bujqësore, etj. Për rrjedhojë krijimi i tyre, ndonëse në parim duket i njëjtë, çdo parti ka elemente të *sui generis-it*, duke i kthyer ato në objekte studimi dhe hulumtimi për shkencat politike e gjithashtu edhe ato juridike. Në këtë kontekst, përmes këtij punimi studiohet dhe hulumtohet lidhur me historikun e partive politike në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë, duke i parë në aspekt krahasimor me vendet e rajonit, së pari në kontekst të partive politike shqiptare në rajon, më pas në nivel të Ballkanit Perëndimor si dhe në krahasim edhe me vendet e BE-së. Duke analizuar kontekstin historik të partive politike në Kosovë dhe Shqipëri dhe krahasuar atë me vendet e tjera, synoj që përmes paraqitjes së të dhënave të mund të nxirren konkluzione dhe rekomandime lidhur me elementet pozitive, por gjithashtu edhe aspektet negative, ashtu që duke kujtuar të shkuarën, të përmirësojmë të ardhmen dhe të vrapojmë më shpejtë aty ku kemi çaluar më shumë dikur.

Fjalë kyçe : Partitë politike, konteksti historik, zhvillimet politike, shteti, sovraniteti.